



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Analizë e shkurtër rreth punësimit të të rinjve në Kosovë

RINI AKTIVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



Prishtinë, prill 2022

Të drejtat e autorit ©2022. **Demokraci për Zhvillim (D4D).**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Instituti Demokraci për Zhvillim

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Rini aktive për zhvillim të qëndrueshëm”, që mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e MKRS-së.

Përmbajtja

| | |
|--------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrja..... | 4 |
| Vlerësimet e qytetarëve për punësim dhe zhvillim të ekonomisë..... | 6 |
| Pozicioni i të rinjve në tregun e punës..... | 10 |
| Masa mbështetëse për rritjen e punësimit të të rinjve..... | 12 |
| Politikat për përmirësimin e pozitës së të rinjve në tregun e punës..... | 15 |
| Praktikat e mira për integrimin e të rinjve në tregun e punës..... | 16 |
| Rekomandimet..... | 17 |

Hyrja

Kosova mbetet prej vendeve me popullsinë më të re në Evropë. Mosha mesatare e popullsisë është 30.2 vjeç, ku të rinjtë nën moshën 25 vjeç përbëjnë rreth 47.3% të popullsisë. Kushtet e tregut të punës në Kosovë mbeten të vështira, veçanërisht për të rinjtë. Gjatë periudhës 2017-2020, dhe norma e punësimit mbeti nën 30%.

Kosova mbetet prej vendeve me nivelin më të lartë të papunësisë në rajon, me një shkallë prej 25% të papunë. Papunësia në mesin e të rinjve është jashtëzakonisht e lartë, ku rreth gjysma e të rinjve nuk kanë asnjë shanse për të gjetur ndonjë punë pas mbarimit të shkollimit. Zakonisht, faktorët kryesor që shtyjnë të rinjtë të migrojnë është mungesa e vende të punës. Kosova po ndanë fatin e njëjtë me vendet e rajonit sa i përket migrimit të intensifikuar të njerëzve të rinjë dhe të arsimuar.

Statistikat zyrtare për migrim të hartuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ofrojnë të dhëna si për largimet e popullsisë ashtu edhe për hyrjet. Bilanci i këtyre lëvizjeve është vazhdimisht negativ. Pas pikut të vitit 2015, ku mbi 74,000 persona emigruan, pasuan dy vjet zbutje të kësaj tendence. Pas kësaj, fluksi i emigracionit u intensifikua përsëri me bilanc negativ prej mbi 21,000 persona dhe pothuajse 29,000 respektivisht në 2018 dhe 2019. Në çdo rast, në periudhën 2015-2019 Kosova regjistroi një bilanc negativ migrimi prej mbi 120,000 njerëz.

Rezultatet e një studimi të WFD rreth migrimit të të rinjve në Kosovë¹, tregojnë se kostoja totale e arsimit të njerëzve që largohen nga Kosova në një vit, varësisht nga struktura arsimore, varion nga pak më shumë se 180 milionë në pothuajse 205 milionë euro. Çdo individ i punësueshëm që emigron nga Kosova merr mesatarisht gati 17.000 euro në vit në PBB-në e mundshme vjetore të ardhshme që mund të ishte realizuar nëse flukset ekonomike do të kishin mundësuar punësimin e tyre produktiv, që do të thotë një humbje vjetore në Prodhimit të Brendshëm Bruto e mundshme në vlerë prej rreth 519 milionë euro.

Pandemia COVID-19 ka vështirësuar edhe më tej mundësitë për punësim në përgjithësi në shumicën e sektorëve, që rrjedhimisht ka ndikuar negativisht edhe në punësimin e të rinjve dhe gjendjen e tyre socio-ekonomike. Përderisa në vitin e parë të shpërndarjes së pandemisë COVID-19 kishte një mbyllje totale të ekonomisë, në vitet pasuese gjendja fillojë të përmirësohet, pasi filluam të adaptohem me “normalen e re”. Paketë financiare të Qeverisë që shpërndara, ishin të domosdoshme për të lehtësuar pasojat ekonomike të qytetarëve dhe bizneseve.

Kjo analizë e shkurtër ka për qëllim të matë vlerësimet e qytetarëve lidhur me gjendjen e tyre socio-ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, gatishmërinë e tyre për të imigruar jashtë vendit në rast se do të kishin një ofertë për punë, për faktorët që ndikojnë

¹ “Kostoja e emigrimit të të rinjve në Kosovë”. WFD dhe D+. I qasheëm në: <https://dplus.org/publikimet/kostoja-e-emigrimit-te-te-rinjve/9965/>


në shkallën e ulët të papunësisë në mesi e të rinjve në Kosovë, si dhe për ku e shohin potencialin për zhvillim ekonomik të vendit. Matja e opinionit publik është bërë përmes mostrës përfaqësuese në nivel vendi, ku të përfshirë kanë qenë 1,065 persona të anketuar nga data 5 deri më 18 mars 2022.

Më tej janë analizuar të dhënat statistikore lidhur me punësimin, trajnimin, praktikën në punë si dhe mundësinë e migrimit të të rinjve jashtë vendit. Të dhënat tregojnë se situata gjatë vitit 2020 është përkeqësuar sa i përket punësimit të të rinjve është përkeqësuar në krahasim me vitin paraprak. Në fund, janë ofruar edhe disa mundësi se si të rinjve mund të qasen më lehtë në tregun e punës, sidomos duke përfituar nga masat aktive të tregut të punës të cilat zbatohen nga agjencitë shtetërore.

Vlerësimet e qytetarëve për punësim dhe zhvillim të ekonomisë


D4D ka zhvilluar një anketë me qytetarë përmes mostrës përfaqësuese në nivel vendi, nga data 5 deri 18 mars 2022, për të marrë opinionin e tyre lidhur me punësimin e të rinjve. Në anketë kanë marrë pjesë 1,065 persona, prej të cilëve 49.7% kanë qenë gra dhe 50.3% kanë qenë burra.

1. Nëse do t'u ipej mundësia për të punuar jashtë vendit, a do të pranoni?




Grafiku 1. Gatishmëria për të punuar jashtë vendit

Sa i përket gatishmërisë për të punuar jashtë vendit, mbi gjysma e qytetarëve të anketuar janë të gatshëm për të punuar jashtë vendit nëse do t'u ipej mundësia. Prej tyre, 39.3% do të pranoni të punonin jashtë vendit pavarësisht llojit të punës, kurse 12.5% kanë deklaruar se do të pranoni të punonin jashtë vendit vetëm në profesionin e tyre. Numri i atyre që nuk janë të interesuar për punë jashtë vendit është 43.4%, kurse 4.8% nuk kanë qenë në gjendje të japin përgjigje.




Grafiku 2. Faktorët që ndikojnë në punësimin e të rinjve në Kosovë

Besimi i qytetarëve në punësimin e të rinjve në Kosovë në bazë të meritokracisë është shumë i ulët. Prej numrit të përgjithshëm të qytetarëve të anketuar, vetëm 25% mendojnë se punësimi bëhet në bazë të meritokracisë, respektivisht merret parasysh shkollimi adekuat dhe përgatitja profesionale. Besimi më i madh në punësimin meritokracisë është në mesin e grupmoshave më të reja, ndërmjet 18 dhe 34 vjeç. Dy faktorët kryesorë për punësimin e të rinjve në Kosovë, sipas qytetarëve të anketuar janë lidhjet familjare (75%) dhe përkatësia partiake (65%). Dy opsionet tjera që janë listuar më pak por që ndikojnë në punësim, janë korrupsioni i përgjegjësve për rekrutim (28%) dhe gjinia (23%).




Grafiku 3. Faktorët që merren parasysh për pranim të ofertës për punë

Faktori kryesor që merret parasysh për shqyrtimin e një oferte për punësim, sipas qytetarëve të anketuar është niveli i pagës, ku 46% kanë zgjedhur këtë faktor si më të rëndësishmin. Faktor i dytë është ambienti i punës me 18.2%, kurse orari i punës dhe kohëzgjatja e kontratës janë me 11.4% respektivisht me 11.2%. Puna në përputhje me shkollimin dhe përvojën (8.1%), si dhe respektin nga menaxhmenti (3.6%) janë dy prej opsionet më së paku të përzgjedhura në mesin e faktorëve të listuar në pyetjen lidhur me shqyrtimin e ofertave për punësim. Dallimet më të mëdha në aspektin gjinor janë në dy faktor, tek orari i punës dhe kohëzgjatja e kontratës. Për gratë është më e rëndësishme orari i punës sesa për burrat, kurse gratë do të pranonin edhe kontrata më afatshkurtra sesa burrat. Në faktorët tjerë dallimet gjinore janë shumë të vogla.




Grafiku 4. Arsyet që vështirësojnë punësimin e të rinjve

Punësimi i të rinjve në Kosovë mbetet i ulët, kurse vështirësitë për të gjetur një vend pune në mesin e të rinjve janë më të mëdha. Në mesin e arsyeve që listohen nga qytetarët e anketuar për vështirësitë e të rinjve për të gjetur një vend pune janë mungesa e ofertave në tregun e punës (55%), nepotizmi (51%), mungesa e përvojës së punës (37%), mungesa e përkushtimit të rinjve në punë (30%), dhe mungesa e kualifikimit adekuat me nevojat e tregut (26%). Grupmoshat më të reja prej 18 deri 24 vjeç kanë renditur më shumë mungesën e përvojës së punës si vështirësi për gjetjen e vendit të punës në raport me grupmoshat tjera.



Grafiku 5. Ndikimi i pandemisë në gjendjen socio-ekonomike

Ndikimi negativ i pandemisë COVID-19 në gjendjen socio-ekonomike duket të ketë qenë i madh në Kosovë. Gjysma e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se kanë pasur përkeqësim të gjendjes së tyre ekonomike si pasojë e pandemisë (50%), kurse për 12.5% të tjerë ka pasur përkeqësim të dukshëm. Për rreth një të katërtën, pandemia COVID-19 nuk ka pasur ndonjë ndikim (25%). Për disa të tjerë, pandemia ka sjellë përmirësim të gjendjes së tyre socio-ekonomike. Për 9.4% është përmirësuar, kurse për 1.7% të tjera është përmirësuar dukshëm e që të gjithë janë të punësuar në sektorin privat.



Grafiku 6. Potenciali për zhvillimin e ekonomisë

Sa i përket asaj se ku qytetarët e Kosovës e shohin potencialin më të madh për zhvillimin e ekonomisë së vendit, rritja e prodhimit vendor për qëllim të eksportit shihet si mundësia më e mirë (36.2%), të pasuar nga zhvillimi i industrisë (31.7%). Investimet nga jashtë vendit shihen si një mundësi për zhvillim të ekonomisë nga një e katërta e të anketuarave, kurse rritja e kapaciteteve për ofrim të shërbimeve jashtë vendit është parë si mundësi e mirë nga vetëm 6.7% e qytetarëve të anketuar, dhe atë më së shumti nga grupmosha 35 deri 44 vjeç, kurse për ata mbi 65 vjeç si opsion me potencial më të madh e shohin rritjen e prodhimit vendor për qëllim të eksportit.

Pozicioni i të rinjve në tregun e punës

Ndonëse rinia kosovare perceptohet si pasuri e vendit, ajo është pak e shfrytëzuar. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, të rinjtë janë gati një të pestën e popullsisë së përgjithshme. Ky aset ka mbetur gjatë i pashfrytëzuar: në vitin 2020 gati gjysma e të rinjve (49.1%) të moshës 15-24 vjeç ishin të papunë dhe vetëm 11.4% ishin të punësuar.

Megjithëse shkalla e pjesëmarrjes në arsimin e lartë është rritur, përqindja e të rinjve që nuk janë në punësim, arsim apo trajnim (NEET) është e lartë. Përqindja e popullsisë së moshës 30–34 vjeç me arsim të lartë është në rritje, nga 9.3% në 2012 në 20.9% në 2018. Një përmirësim më i madh vërehet te gratë, pjesëmarrja e të cilave u rrit nga 6.5% në 2012 në 20.8% në 2018, krahasuar me 12.1% për burrat në 2012 dhe 20.9% në 2018. Në vitin 2020, katër në dhjetë të rinj të moshës 15-29 vjeç ishin në NEET (40.4%); e cila është strukturalisht më e lartë në krahasim me mesataren e BE-së dhe Kroacisë (13.7% dhe 14.6%, respektivisht), dhe më shumë se katërfishi i normës në Slloveni (9.2%). Kjo tregon një tranzicion shumë sfidues në tregun e punës për të rinjtë. Vajzat e reja kanë më shumë gjasa të bien në kategorinë NEET - një hendek prej pesë pikë përqindjeje midis të rinjve të moshës 15-29 vjeç.

| | 2018 | | | 2019 | | | 2020 | | |
|----------------------------|----------|------|------|----------|------|------|----------|------|------|
| | Gjithsej | B | G | Gjithsej | B | G | Gjithsej | B | G |
| Shkalla e papunësisë 15-24 | 55.4 | 51.5 | 64.7 | 49.4 | 44.1 | 60.3 | 49.1 | 45.2 | 57.2 |
| Shkalla e punësimit 15-24 | 10.0 | 14.6 | 4.9 | 13.1 | 18.6 | 7.1 | 11.4 | 16.1 | 6.4 |
| Shkalla NEET 15-24 | 30.1 | 30.2 | 30.0 | 32.7 | 31.4 | 34.2 | 33.6 | 34.0 | 33.2 |
| Shkalla NEET 15-29 | 37.3 | 34.4 | 40.6 | 39.9 | 35.6 | 44.8 | 40.4 | 38.0 | 43.0 |

Burimi: KAS, LFS for Kosovo, Eurostat for EU, Croatia and Slovenia:

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/LFSI_EMP_A_custom_1333449/default/table?lang=en

Tabela 1. Pozicioni i të rinjve në tregun e punës

Mungesa e vendeve të punës është një nga arsyet kryesore shtytëse për planet e të rinjve drejt emigrimit. Sipas një studimi të kryer në fillim të vitit 2018 nga Friedrich-Ebert-

Stiftung², 34% e të rinjve kosovarë shprehin një dëshirë të fortë ose shumë të fortë për të lëvizur në një vend tjetër për më shumë se gjashtë muaj. Shumica po kërkonin të lëviznin për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme që varion nga gjashtë muaj (37%) në dy vjet (34%). Një grup i madh të rinjsh (44%) që thanë se do të dëshironin të largoheshin jashtë vendit, pohuan se ishin ftuar ose kishin mbështetjen e individëve që jetonin në vendin e destinacionit të tyre të dëshiruar, duke sugjeruar që ekzistenca e një diaspore të kosovarëve të cilët tashmë kanë emigruar në një vend pritës kontribuon ndjeshëm në emigracionin e ardhshëm në vendin në fjalë. Dëshmi për prevalencë më të lartë të emigrimit tek të rinjtë është përshkruar edhe me një analizë të kohëve të fundit nga Leitner³: duke përdorur qasjen grupore dhe me mikro të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore për Kosovën (2016–2018), Leitner zbuloi se periudha nga 2016 deri në 2018 karakterizohet nga emigrim i konsiderueshëm neto, i cili vlerësohet në rreth 53,000 njerëz në total. Me mbi 20,000 njerëz, emigracioni neto ishte më i larti në mesin e grupeve më të reja, veçanërisht ato në fillim të të njëzetat deri në fillim të tridhjetave (d.m.th. grupet e moshës 15–19 dhe 20–24 vjeç) midis 2016 dhe 2018. Një shtytës i rëndësishëm pas këtij modeli është situata e dobët e tregut të punës së të rinjve, veçanërisht një shkallë jashtëzakonisht e lartë e papunësisë tek të rinjtë dhe perspektiva e dobët e punësimit në të ardhmen. Anasjelltas, ka pasur imigrim neto midis dy grupmoshave më të vjetra, veçanërisht grupit të dytë më të vjetër të njerëzve nga mesi i të tridhjetave deri në fillim të dyzetave (d.m.th. grupi i moshës 30–34 vjeç) midis 2016 dhe 2018.

² Lavrič et al. “Youth Study Southeast Europe 2018/2019”. *Friedrich-Ebert-Stiftung*. I qasshëm në: <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15274-20190408.pdf>

³ “How migration, Human Capital and the Labour Market Interact in Kosovo”. *European Training Foundation (ETF)*. I qasshëm në: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2021-07/migration_kosovo.pdf

Masa mbështetëse për rritjen e punësimit të të rinjve

Qasja e të rinjve në shërbimet publike të punësimit po rritet në terma absolute dhe relative. Të dhënat e paraqitura në tabelën 2 tregojnë se krahasuar me vitin 2018, numri i të rinjve që marrin pjesë në ALMM dhe trajnime profesionale është rritur me rreth një mijë. Ndërsa të rinjtë përbëjnë rreth një të pestën e të papunëve, përfaqësimi i tyre brenda kursantëve profesional është afro 40% dhe afro 30% midis përfituesve të Masave Aktive të Tregut të Punës (ALMM). Në vitin 2019, gati 30% e të rinjve përfituan nga trajnime profesionale apo ALMM, por për shkak të rritjes së numrit të të papunëve të regjistruar në vitin 2020 (nga 12,709 në 2019 në 28,130 në 2020), mbulimi me ALMM dhe trajnime në vitin 2020 ra në 72%.

Në vitin 2020/21, 54% e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë studionin në shkollat e AAP. Ndërsa shkollat e AAP-së synojnë të përgatisin të rinjtë për botën reale të punës, dëshmitë tregojnë se nxënësve të AAP-së u mungojnë mundësitë për të zhvilluar aftësi praktike në vendin e punës. Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit për Punësimin e të Rinjve 2018-2020 ka raportuar një progres në lidhje me aktivitetet që synojnë harmonizimin e arsimit dhe formimit profesional me kërkesën e tregut të punës (janë miratuar 36 standarde të reja profesionale, ku standardet e punës janë miratuar për 64 % e profileve të studimit të shkollave të AAP-së Megjithatë, sfida mbetet vendosja e nxënësve të AAP-së: në periudhën janar-qershor 2018, vetëm 366 nxënës të AAP-së (nga 40,000) u vendosën në ndërmarrje për qëllime praktike.

Mospërputhja e arsimit me nevojat e tregut të punës është një sfida urgjente për Kosovën dhe dëmton perspektivat e të rinjve në tregun e punës. Një anketë e 2017⁴ zbuloi se vetëm një në tre individë raportoi se puna e tyre aktuale ose më e fundit ishte e lidhur me fushën e tyre kryesore të studimit. Sipas fushave të studimit, përqindja më e ulët e individëve që punojnë në fushën e tyre të studimit u gjet në programet e përgjithshme (8%), të ndjekur nga shkencat fizike (15%) dhe matematika dhe statistikat (27%). Përqindja më e lartë e individëve që punojnë në fushën e tyre të studimit u gjet në trajnimin dhe edukimin e mësuesve (76%), shëndetin dhe mirëqenien (62%) dhe shkencat e jetës (51%). 66.2% e individëve që treguan se puna e tyre aktuale ose më e fundit nuk lidhej me fushën e tyre të studimit u pyetën pse. Një shumicë dërrmuese e tyre (91.9%) treguan se kjo ishte për shkak se nuk kishte punë në dispozicion në fushën e tyre të studimit. Sondazhi STEP i Bankës

⁴ "Kosovo Labor Force and Time Use Study Research Report". Millennium Challenge Corporation. I qasshëm në: <https://millenniumkosovo.org/wp-content/uploads/2018/11/MCC-Kosovo-Labor-Force-and-Time-Use-Study-Final-Research-Report-1.pdf>

Botërore⁵, i cili u krye në 2016/17, zbuloi se 23% e punëtorëve e konsideronin veten të mbi-arsimuar dhe 11% të nën-arsimuar, ndërsa shumica e individëve me arsim pas të mesëm, jo-terciar e konsideronin nivelin e tyre të arsimimit shumë të ulët për çfarë kërkohej nga puna në Kosovë.

| | 2018 | 2019 | 2020 |
|-------------------------------------------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|
| Numri i të rinjve të regjistruar në APRK | 18,741 | 12,709 | 28,130 |
| Përqindja e të rinjve në numrin e përgjithshëm të të papunëve të regjistruar | 19.5% | 18% | 16% |
| Numri i të rinjve që përfitojnë nga ALMM dhe trajnimet profesionale në EARK | 2,719 | 3,806 | 3,573 |
| Numri i të rinjve që përfitojnë nga trajnimet profesionale | 2,033 | 2,522 | 1,300 |
| Numri i të rinjve që përfitojnë nga ALMM | 686 | 1,284 | 2,273 |
| Mbulimi i të rinjve të regjistruar në EARK me ALMM dhe trajnime | 14.5% | 29.9% | 12.7% |
| Përqindja e të rinjve në mesin e përfituesve të trajnimit profesional | 37% | 38.2% | 37.8% |
| Pjesa e të rinjve në mesin e përfituesve të ALMM | 22.8% | 27.8% | 40.4% |

Burimi: *MPMS, Puna dhe Punësimi 2018, 2019 dhe 2020.*

Tabela 2: Pjesëmarrja e të rinjve në ALMM dhe trajnime profesionale

Qeveria e re në Kosovë ka ndërmarrë hapa për orientimin e talentëve të rinj në fusha me interes publik dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës. Qeveria ka ndarë 2 milionë euro për trajnime dhe punësim në masën *IT 1.5 të Paketës së Rimëkëmbjes Ekonomike*. Kjo masë synon mbështetjen financiare të studentëve përmes bursave, si dhe trajnimin e të rinjve për punësim në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Një milion euro u ndanë për subvencionimin e bursave për vajzat në fushën e STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) dhe një milion euro do të përdoren për trajnimin e të rinjve të diplomuar në fushën e IT.

⁵ “Kosovo Country Report: Findings from the Skills towards Employment and Productivity Survey”. *World Bank Group*. I qasshëm në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/209751557432399449/Kosovo-Country-Report-Findings-from-the-Skills-towards-Employment-and-Productivity-Survey>

Siç raportohet në Programin e Reformës Ekonomike 2022-2024, Grupi i Punës për Garancitë Rinore (YGTT) është duke hartuar Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore (YGIP) dhe ofrimi i sistemit është në proces. Procesi po mbështetet nga ILO dhe ETF. Deri në mars/prill 2022, drafti YGIP do të ndahet me EC/ILO/ETF për reagime teknike. Deri në gusht 2022, YGIP do të finalizohet dhe dorëzohet. Si pjesë e këtij procesi, tashmë ka filluar përgatitja e profilit statistikor të NEET-ve të rinj në Kosovë bazuar në të dhënat në dispozicion të prodhuara nga Agjencia e Statistikave. Gjithashtu, rishikimi i politikave të punësimit të të rinjve është në rrugë e sipër dhe qeveria planifikon të zgjerojë masat aktive të tregut të punës për të papunët afatgjatë, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2022. Zbatimi i Garancisë për Rininë është planifikuar të fillojë në 2023.

Politikat për përmirësimin e pozitës së të rinjve në tregun e punës

Shkalla e lartë e punësimit të të rinjve trajtohet në disa politika të qeverisë. Programet e Reformës Ekonomike 2021-2023 synojnë përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve publike të punësimit dhe rritjen e punësimit të të rinjve të papunë afatgjatë, grave dhe grupeve të tjera të cenueshme. ERP 2021-2023 synon që deri në vitin 2021, 34% e përfituesve të ALMM të EARK të jenë të rinj. Ky objektivi u tejkalua në vitin 2020, duke zënë 40.4% të përfituesve të ALMM, por vetëm 13% të përfituesve të trajnimit (Tabela 2). Strategjia Sektoriale e MPMS-së ka pasur edhe përmirësimin e pozitës së të rinjve kosovarë në tregun e punës, por ajo është në vitin e fundit të zbatimit.

Kosova ka zhvilluar një plan veprimi specifik me qëllim rritjen e punësimit tek të rinjtë. Plani i Veprimit mbuloi periudhën 2018-2020 duke synuar rritjen e qasjes në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve publike cilësore dhe në kohë të punësimit dhe arsimit dhe trajnimit profesional, rritjes së mbulimit të të rinjve brenda ALMM-ve, qasjes në mundësitë e sipërmarrjes dhe duke mbështetur mbështetjen e zhvillimit të biznesit, dhe bizneset në pronësi të të rinjve. Pozita e pafavorshme e të rinjve synohet të përmirësohet me një Plan Veprimi specifik për Punësimin e Rinisë 2018-2020. Si një dokument ndër-sektorial, Plani i Veprimit synonte të përmirësonte kalimin e të rinjve në tregun e punës, nëpërmjet rritjes së qasjes në ALMM, përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe trajnimit profesional, mundësive për sipërmarrje, mbështetjes së biznesit për bizneset në pronësi të të rinjve dhe angazhimit të të rinjve në sektorin e bujqësisë. Monitorimi i zbatimit të këtij plani veprimi të publikuar në vitin 2020 zbuloi se pavarësisht rritjes së mbështetjes për të rinjtë në shumicën e ndërhyrjeve, treguesit e synuar nuk u arritën. Norma e punësimit për të rinjtë në vitin 2020 ishte planifikuar të arrinte në 15% ndërsa të dhënat e AFP tregojnë se ajo u rrit vetëm me 1.3 pikë përqindje (11.4% në 2020). Në mënyrë të ngjashme, objektivi për NEET për vitin 2020 ishte 20% dhe në 2020 ishte 31.5% një rënie prej 1.4 pikë përqindje që nga viti 2018. Një përparim është arritur në lidhje me qasjen në ALMM të zbatuar nga Agjencia e Punësimit: në 2019, ku të rinjtë përbënin 38.2% të përfituesve të formimit profesional dhe 27.8% të ALMM-ve, dukshëm më i lartë se përfaqësimi i tyre midis të papunëve të regjistruar.

Ndikimi i përpjekjeve për rritjen e punësimit të të rinjve deri tani, mbetet i dobët. Në vitin 2020 është bërë monitorimi i viteve 2018-2020 (MPMS, 2021) dhe përderisa është raportuar progres në realizimin e aktiviteteve, është shënuar progres i kufizuar në arritjen e treguesve të synuar. Norma e punësimit për vitin 2020 ishte planifikuar të arrinte në 15% ndërsa të dhënat e AFP tregojnë se ajo u rrit vetëm me 1.3 pikë përqindje (11.4% në 2020). Në mënyrë të ngjashme, objektivi për NEET për vitin 2020 ishte 20% dhe në 2020 ishte 31.5% një rënie prej 1.4 pikë përqindje që nga viti 2018.

Qeveria ka nisur procesin e zhvillimit të Strategjisë së Punësimit, një dokument politikash ndër-sektorial për të bashkuar përpjekjet nga të gjitha institucionet përkatëse për rritjen e perspektivës së punësimit. Garancia për të rinjtë është planifikuar të fillojë të zbatohet në vitin 2023, për të cilën janë përcaktuar pritshmëri të mëdha.

Praktikat e mira për integrimin e të rinjve në tregun e punës

Një lajm i mirë është ndryshimi në programet aktive të tregut të punës që i synojnë posaçërisht të rinjtë kosovarë. Aktualisht janë duke u zhvilluar negociata për zbatimin e skemave për të rinjtë në Kosovë, që është e ngjashme me skemën e BE-së "Youth Guarantee", mbase në kuadër të programit IPA 2022. Sipas skemës "Youth Guarantee", të gjithë të rinjtë nën moshën 30 vjeçare duhet ta marrin një ofertë të cilësisë së mirë për punësim, arsimim të vazhdueshëm, praktikë ose trajnim brenda një periudhe prej katër muajsh pasi të mbeten pa punë ose pasi ta mbarojnë arsimin formal. Duke pasur parasysh shkallën shumë të lartë të papunësisë së të rinjve në Kosovë, iniciativat si "Youth Guarantee", janë shumë të nevojshme.

Ekziston nevoja për një monitorim më të mirë të tregut të punës në Kosovë, kryesisht për sa i përket parashikimit të nevojave të tregut të punës për shkathtësi në sektorë të ndryshëm dhe për identifikimin e listave të profesioneve deficitare. Edhe pse po diskutohet për disa pilot iniciativa për projektet e financuara nga BE-ja në këtë fushë (p.sh. planet për prodhimin e një barometri të tregut të punës dhe/ose barometrit të shkathtësive), ai është larg nga profesionet dhe shkathtësitë për të cilat dihet se mungojnë për shkak të migrimit të fuqisë punëtore.

Mbështetja e të rinjve përmes masave aktive që janë në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre dhe në masat që ofrojnë mundësi më të mëdha për të gjetur punë. Një vlerësim i fundit i ALMP-së⁶ zbuloi se shkalla e punësimit në kohën e anketës (gjashtë muaj ose më shumë pas përfundimit të skemës) sillet ndërmjet 41% midis përfituesve të trajnimit në punë, 50.7% midis përfituesve të subvencionimit të pagave, dhe 43.4% midis praktikantëve. Këto gjetje mund të tregojnë se punëdhënësit e përdorin ALMP-në për t'i punësuar të papunët e regjistruar si fuqi punëtore relativisht të lirë.

⁶ Rizvanolli et al. "Masat aktive të tregut të punës: A janë vegla efektive për adresimin e sfidave të punësimit dhe aftësisimit të fuqisë punëtore në Kosovë?" I qasshëm në: <https://yesforkosovo.org/wp-content/uploads/2019/12/Report-ENG.pdf>

Rekomandimet

- Ofrimi i shërbimeve profesionale të këshillimit dhe edukimit për karrierë për secilin të ri/re gjatë shkollimit. Përmes ofrimit të këtij shërbimi të rinjtë do të mund të përgatiteshin më mirë dhe në kohë për sfidat që i presin si dhe do të mund të orientoheshin më mirë për të bërë zgjedhjen e duhur të karrierës. Këto shërbime duhet të ofrohen nga zyrtarë profesional duke filluar nga zyrat e punësimit të nivelit qendrorë ashtu edhe nga profesionistë të angazhuar nga Ministria e Arsimit.
- Zhvillimi i një plani nacional për sektorë të caktuar ku do të mund të ofrohej shkollimi dual apo shkollimi profesional i përcjellur me praktikë në punë. Duhet bërë identifikimi i sektorëve si dhe i mundësive të sektorit privat për ti marrë këta të rinjtë në praktikë gjatë shkollimit të tyre. Një zhvillim i tillë do të rriste gjasat e të rinjve për t'u punësuar.
- Vazhdimi i mbështetjes së vazhdueshme përmes masave aktive të tregut të punës ku shënjestrohen vetëm të rinjtë pasi që kjo masë ka pasur suksese në të kaluarën. Duke marrë parasysh ndikimin negativ të pandemisë në sektorin e punësimit, masat duhet t'i përshtaten realitetit në terren dhe të rrisin kohëzgjatjen e përkrahjes si për bizneset që i punësojnë të rinjtë ashtu edhe për të rinjtë.
- Përkrahja financiare dhe jo financiare për të gjithë të rinjtë që kanë ide dhe dëshirojnë të hapin biznesin e tyre. Secila ide që përcillet me një plan biznesi dhe që vlerësohet pozitivisht nga një komision profesional duhet të përkrahet. Mundësia për të përfituar nga kjo masë duhet të jetë e hapur gjatë tërë vitit dhe të përkrahet nga buxheti i shtetit.
- Përmes programit nacional për aktivizimin e të rinjve, duhet që secili i ri të jetë i angazhuar ose në punë, shkollim, apo në trajnim. Përmes këtij programi të financuar nga buxheti i shtetit bëhet identifikimi i të rinjve të cilët janë pasivizuar nga tregu i punës dhe atyre i ofrohet një paket-ofertë ku përfshinë mundësinë e trajnimit, praktikës, shkollimit të mëtutjeshëm apo edhe punësimit.

Bibliografia

Rizvanolli et al. “Masat aktive të tregut të punës: A janë vegla efektive për adresimin e sfidave të punësimit dhe aftësimit të fuqisë punëtore në Kosovë?” I qasshëm në: <https://yesforkosovo.org/wp-content/uploads/2019/12/Report-ENG.pdf>

“Kosovo Labor Force and Time Use Study Research Report”. *Millennium Challenge Corporation*. I qasshëm në: <https://millenniumkosovo.org/wp-content/uploads/2018/11/MCC-Kosovo-Labor-Force-and-Time-Use-Study-Final-Research-Report-1.pdf>

“Kosovo Country Report: Findings from the Skills towards Employment and Productivity Survey”. *World Bank Group*. I qasshëm në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/209751557432399449/Kosovo-Country-Report-Findings-from-the-Skills-towards-Employment-and-Productivity-Survey>

Lavrič et al. “Youth Study Southeast Europe 2018/2019”. *Friedrich-Ebert-Stiftung*. I qasshëm në: <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15274-20190408.pdf>

“Kostoja e emigrimit të rinjve në Kosovë”. WFD dhe D+. I qasshëm në: <https://dplus.org/publikimet/kostoja-e-emigrimit-te-te-rinjve/9965/>

How migration, Human Capital and the Labour Market Interact in Kosovo”. *European Training Foundation (ETF)*. I qasshëm në: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2021-07/migration_kosovo.pdf

Lista e publikimeve

Analizë e politikave dhe hulumtim

Valëza Zogjani, Gentiola Madhi dhe Boris Žerjav. Nëntor 2018. [Konektivitet për zhvillim: Rruga drejt zhvillimit ekonomik.](#)

Visar Xhabazi. Dhjetor 2019. [EU Initiatives Signal No Breakthrough in Kosovo-Serbia Dialogue](#) (English version only).

[Valëza Zogjani, Ana Nenezić, dhe Nirvana Deliu.](#) Redaktuar nga: Shpend Emini. Janar 2020. [Evoluojnë apo sillen në rreth: Reformat institucionale dhe legjitimiteti demokratik në Kosovë, Shqipëri dhe Mal të Zi.](#)

Valëza Zogjani. Mars 2020. [Implikimet e mundshme gjinore të COVID-19 në Kosovë.](#)

Gersi Gashi. Qershor 2020. [Mobiliteti i fuqisë punëtore: Një qasje nga poshtë-lart.](#)

Dita Dobranja. Korrik 2020. [Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i grave anëtare të Kuvendeve të Komunave në qeverisje locale.](#)

Demush Shasha. Tetor 2020. [Udhërrëfyesi për anëtarësim në Bashkimin Evropian: Dy skenarë për Kosovën.](#)

Valëza Zogjani. Nëntor 2020. [Raport mbi performancën e komunave në fushën e komunikimit me qytetar/e.](#)

Kimberley Kruijver, Visar Xhambazi. Dhjetor 2020. [E ardhmja e Kosovës në NATO: Si të arrihet e pamundura?](#)

Anette Sonnabäck, Valëza Zogjani. Gusht 2021. [Rruga e Kosovës drejt evropianizimit: Tejkalimi i mekanizmave nga lart-poshtë.](#)

Bodo Weber. Shtator 2021. [E ardhmja e politikës së zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor pas Merkelit.](#)

Valëza Zogjani. Shtator 2021. [Kosto e pabarazisë: Financimi i fushatës zgjedhore së grave kandidatë.](#)

Charles King. Nëntor 2021. [Politika e Jashtme e ShBA-së në Kosovë: Pasqyrë e shkurtër nga Bushi te Bideni.](#)

Instituti D4D. Mars 2022. [Portalet dhe mediat sociale në Ilupë.](#)

Zgjedhjet dhe partitë politike

Instituti D4D. Shtator 2011 [Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.](#)

Instituti D4D. Mars 2012. [Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?](#)

Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. [Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën](#)

Malazogu, Leon dhe Selatin Klllokoqi. Shkurt 2013. [Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?](#)

Malazogu, Leon dhe Selatin Klllokoqi. Shtator 2013. [Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.](#)

Malazogu, Leon dhe Selatin Klllokoqi. Shtator 2013. [Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero](#)

Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 26 nëntor 2014. [Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike](#)

Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, korrik 2015. [Vendosja e drejtësisë në zgjedhje](#)

Leon Malazogu me kontributin e Ngadhnjim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015 [Trendet zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit](#)

Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi. Shkurt 2016 [Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor](#)

Dr. Besnik Pula, maj 2018. [Demokracia e Kosovës në rrezik? Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë.](#)

D4D, shtator 2018. [Agjendë për reformën zgjedhore: Drejt përfaqësimit të vërtetë.](#)

D4D dhe Demokraci Plus (D+), tetor 2018. [Votimi nga jashtë vendit: Shqyrtimi i politikave dhe rekomandimeve praktike.](#)

Instituti D4D. Prill 2020. [Sa miqësore janë partitë politike ndaj të rinjve?](#)

Dardan Berisha. Shtator 2020. [Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje: Çfarë është vendosur për ankesat, apelet dhe lëndët penale të zgjedhjeve.](#)

Instituti D4D. Dhjetor 2020. [Busulla ideologjike e Kosovës: Evolucioni i orientimit partiak 2014-2020, Vlerat dhe Popullizmi.](#)

Blerinë Ukshini. Mars 2021. [Zgjedhje në kohë pandemie: Menaxhimi kundrejt Pasojave.](#)

Instituti D4D. Maj 2021. [Zgjedhjet para gjykatës: Kontestet zgjedhore në Kosovë.](#)

Instituti D4D. Janar 2022. [Fushata zgjedhore në llupë.](#)

Rekomandimet e Forumit Reforma

Instituti D4D. 29 nëntor 2011. [Struktura e KQZ-së](#)

Instituti D4D. 17 janar 2011. [Sistemi zgjedhor](#)

Instituti D4D. 29 nëntor 2011. [Riparimi i listës së votuesve](#)

Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. [Rekomandimet për Zgjedhjen e Presidentit të Kosovës](#)

D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. [Reformë të mirëfilltë zgjedhore](#)

Dialogu dhe bashkëpunimi rajonal

Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. [Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/D4D Institute and NPC-Belgrade](#)

#2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emmini. Mars 2012. [Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.](#)

Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. [Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/Instituti D4D](#)

Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. [Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D](#)

Ejdus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës: Drejt një ekuilibri të ri? Publikuar bashku CEPI, BCSP dhe D4D. (Vetëm në gjuhën angleze)

Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Ajete Kërçeli. Me kontribut nga: Shpend Emmini, Rezarta Delibashzade dhe Ferid Murseli. Tetor 2016. [Gratë e fuqizuara: çelës për transformimin e komuniteteve](#)

Instituti D4D. Dhjetor 2016. [Peer-2-Peer: Ndarja e përvojave](#)

Luke Foley. Mars 2021. [Bllokimi i suksesshëm: Si e ndali fushata e Serbisë për çnjohje ngarendjen e Kosovës drejt njohjes universale.](#)

Visar Xhambazi. Maj 2021. [Mini-Shengeni dhe Bashkëpunimi Rajonal: Nevojiten gjashtë shtete për bashkëpunim në Ballkanin Perëndimor.](#)

Qeverisja dhe Interesi Publik

Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. [‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?](#)

Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. [Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë](#)

Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. [Le të ngrihet shoqëria civile e vërtetë: Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik](#)

Miftari, Naser. Shtator 2013. [Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë](#)

Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. [Sa kushton patriarkati?](#)

Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 [Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikë, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra](#)

Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 [Reformimi i Universitetit të Prishtinës – mission i mundur?](#)

Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor, 2016. [Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë](#)

Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. [Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës](#)

Isuf Zejna. Korrik 2017. [Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas.](#)

Visar Sutaj. Tetor 2017. [Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?](#)

Linda Abazi Morina dhe Rezarta Delibashzade. Me contribute nga Ajete Kërçeli dhe Valëza Zogjani. Nëntor 2017. [Joaktiviteti i grave në tregun e punës.](#)

Ajete Kërçeli. Me contribute nga Ardiana Gashi. Dhjetor 2017. [Ndryshimi i paradigmes – Barazi përmes lejes prindërore.](#)

Vjollca Krasniqi. Mars 2018. [Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat.](#)

Khavit Rexhaj. Me kontribut nga Rasim Alija. Prill 2018. [Funksionimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës: Analizë e punës dhe vendimeve.](#)

[Krenar Gashi dhe Gersi Gashi. Rishikuar nga Dr. Besnik Pula. Nëntor 2018. Zanafilla plus dhjetë: Analizë e dekadës së parë të shtetësisë së Kosovës.](#)

[Aliriza Arenliu dhe Gersi Gashi, me contribute nga Elmedina Bajgora. Mars 2019. Matja dhe vlerësimi i politikave të riintegrit: Politika të bazuara në dëshmi për të siguruar riintegrim të qëndrueshëm.](#)

Alba Boshnjaku dhe David JJ Ryan. Qershor 2019. [Parental Rights in Kosovo: Legal analysis regarding the proposed amendments to maternity and parental leave](#) (vetëm në anglisht).

Kaltrina Temaj. Rishikuar nga: Valëza Zogjani. Shtator 2019. [Inclusion of Women in decision-making and local governance in Kosovo](#) (vetëm në gjuhën angleze).

Albert Krasniqi. Dhjetor 2020. [Analizë mbi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës në periudhën 2019-2020.](#)

Judita Krasniqi. Janar 2021. [Kush e paguan çmimin më të lartë? Ndikimi i Covid-19 në punësimin e grave në Kosovë.](#)

Instituti D4D. Tetor 2021. [Administrata Komunale në Mitrovicën e Jugut: Reforma si mekanizëm i zhvillimit.](#)

Instituti D4D. Nëntor 2021. [Fondi i Sigurimeve Shoqërore: Mbulimi financiar i Lejes Prindërore.](#)

Instituti D4D. Mars 2022. [Ofrimi i shërbimeve digjitale në nivel lokal në Kosovë: Komuna e Podujevës, Lipjanit dhe Drenasit.](#)

Memorandume Reaguese

Instituti D4D. Nëntor 2012. [Memorandumi reagues Nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë](#)

Instituti D4D. Dhjetor 2012. [Memorandumi reagues Nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive](#)

Instituti D4D. 12 Korrik 2013. [Memorandumi reagues Nr. 3 – Kriteria të qarta për komuna të reja](#)

Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. [Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz](#)

Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. [Memorandum reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore](#)

Instituti D4D. Nëntor 2016. [Memorandum reagues nr.6 – Reforma zgjedhore](#)

Indikatorët & skenarët

Instituti D4D. Nëntor 2010. [Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010](#)

Instituti D4D. Qershor 2011. [Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë](#)

Malazogu, Leon. Nëntor 2013. “As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do të afrojë palët në lidhje me asociacionin/bashkësinë”. *(Vetëm në gjuhën angleze)*

Malazogu, Leon. Janar 2014. [Parashikime dhe skenare: Kosova dhe Bota në 2014](#)

Agon Nixha. Nëntor 2017. [“Analizë e shkurtër e politikave. Investimet e huaja direkte dhe eksportet: Kosova dhe Ballkani Perëndimor.”](#)

[Seritë e editorialeve dhe rekomandimeve mund gjithashtu të gjinden në ueb-faqen tone.](#)

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po bregoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtet ndërtimit e kishte lënë anash demokracinë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org

Mbështetur nga:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

ISBN 978-9951-823-29-6



9 789951 823296